

Më
Dana 30-04-2018

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,
Divizioni penal si gjykatë e shkallës së parë me gjyqtarë , Hysnije Gashi si dhe me
zyrtarë ligjorë Albana Ujupi, në çështjen penale kundër të akuzuarit, [REDAKTUAR] me
vendbanim në fshatin [REDAKTUAR] Komuna Viti, për shkak të veprës penale rrezikimi trafikut
publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë
Themelore në Ferizaj PP/II.nr.753-2/2016 të dt.30.11.2017, duke vendosur lidhur me
kërkesën e PTH në Ferizaj, për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata
me dt.13.02.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTHF në Ferizaj PP/II.nr.753-2/2016 të dt.30.11.2017, dhe kjo
gjykatë shqipton këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri

[REDAKTUAR] me vendbanim në fshatin [REDAKTUAR] Komuna Viti, i lindur më datë
[REDAKTUAR] me nr. Personal: [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] e ëma [REDAKTUAR], e gjinisë
[REDAKTUAR], ka të kryer shkollën mesme, i gjendjes së varfer ekonomike, shqiptar, shtetas i
Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 12.05.2016, rreth orës 11:25, në rrugën " Kadri Zeka", duke drejtuar automjetin
e markës "Mercedes" me targa të regjistrimit [REDAKTUAR], duke vepruar në kundërshtim
me dispozitat e nenit 42/I të LSKRR-së, nga pakujdesia gjatë kthimit majtas për tu
shkyqur nga rruga nuk është siguruar se me këtë veprim nuk do të rrezikoj pjesmarrsit e
tjer dhe pa shikuar retrovizorin e majtë gjatë kthimit e godet me ansoren e majtë të derës
se vozitsit , motoqikletën e markës "BMW" të cilën e drejtonte [REDAKTUAR] me të

cilen rast pos demve materiale lendime te lehta trupore pesojne [REDACTED] dhe [REDACTED], lendime keto te pershkrurara ne ekspertizen mjeko ligjore te dates 08.11.2017,-

Me te cilën kreu veprën penale rrezikimi trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së

Andaj , Gjykata në bazë të nenit 4,41,46, dhe 73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së,

G J Y K O N

Të pandchurit, me dënim me gjobë në shumë prej 200€, (dyqind euro) të cilin dënim është i obliguar ta paguaj ne në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Të dëmtuarit [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna Ferizaj dhe [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Viti, per realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohen ne kontest civil

Obligohet i pandchuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej 55.55€ dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.753-2/2016 të dt.30.11.2017, ka akuzuar të pandehurin [REDACTED] me vandbanim ne fshatin [REDACTED] Komuna Viti, për

shkak te veprës penale rrezikimi trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP/II.nr.753-2/2016 të dt.30.11.2017, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1 të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës që në fazën e administrimit të provave si: ekspertiza mendimi i ekspertit mjeko ligjore te dates 08.11.2017 , konstatimi i eksperit te komunikacionit rrugor i dates 24.08.2017, deklarata e te pandehurit e dates 13.08.2017 dhe deklarata e te demtuarit te dates 13.05.2016 si dhe te behet shiqimi ne fotografit qe gjenden ne shkresat e lendve.

Të dëmtuarit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj dhe [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Viti, per realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen ne kontest civil

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej 55.55€ dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.


GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

DIVIZIONI PENAL

P.nr.3045/17 dt.13.02.2018

Zyrtare ligjore,
Albana Ujupi

Gjyqtari i vetem gjykues,
Hysnije Gashi



UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim,
në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.